



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2022:116875
Datë: 09.08.2024
Numri i dokumentit: 06035558

P.nr. 215/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-DEGA NË VITI, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit Behar Ymeri, me bashkëpunëtoren profesionale Kadishe Ajvazi Demi, në lëndën penale kundër të pandehurit M.Z...nga fshati K..., komuna e V..., për shkak të veprës penale Ndotja, degradimi apo shkatërrimi i mjedisit nga neni 338 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-s), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.842/2022, të datës 01.06.2022 dhe kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor PP.II.nr.842/2022, të datës 31.05.2024, më datën 09.08.2024, mori këtë :

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, për dhënien e urdhërit ndëshkimor ndaj të pandehurit: M. (R.) Z., nga fshati K..., komuna e Vitisë, i lindur më .., me numër personal:1..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Është fajtor

Sepse më datën 16.05.2022 rreth orës 19:00 në Viti, i pandehuri M.Z..., ka shfrytëzuar resurset minerale në mënyrë të jashtëligjshme, ashtu që i njëjti ka degraduar bregun e Lumit “Morava e Binqës” duke eksploatu dheun nga pellgu i Lumit për nevoja biznesi ose privat, i cili ditën kritike është hasur nga inspektorët Afrim Sylejmani dhe Elbasan Shala duke ngarkuar dhëun në kamionetën e tij të tipit “Iveko” me tabela të regjistrimit ..., ku me rastin e daljes së inspektorve nga automjeti zyrtar i dyshuari në mënyrë të vrullshme ka hypur në automjetin e tij dhe ka ikur nga vendi i ngjarjes në këtë mënyrë i njëjti ka krijuar rreziqe, ndotje, degradim apo shkatërrim të mjedisit.

Me këtë ka kryer veprën penale Ndotja, degradimi apo shkatërrimi i mjedisit nga neni 338 paragrafi 1 të KPRK-s.

Andaj, në bazë të dispozitës së lartë cekur ligjore dhe neneve 4, 38, 43, 45,69,70,71, dhe 72 të KPRK, dhe nenit 495 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të pandehurit i shqipton,

DËNIM ME GJOBË

I. Të pandehurit M.Z...i caktohet dënim me gjobë në shumë prej 200 € (dyqind euro) të cilin dënim është i obliguar që ta paguajë brenda afatit prej 30 ditë nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

II. Nëse i akuzuari refuzon të paguajë dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje ta paguaj atë atëherë dënimi me gjobë me pajtimin me të akuzuarin do të zëvendësohet me punë në dobi të përgjithshme ashtu që 8 (tetë) orë të punës do të barazohen me 20 € (njëzet euro) ndërsa nëse i akuzuari nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimit me gjobë me punë në dobi të përgjithshme atëherë dënimi me gjobë do të

zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzet euro) do ti caktohet një ditë burgim.

III. E dëmtuara, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale në Prishtinë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontëst të rregullt civil.

IV. Obligohet i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale aq sa do të bëhen sipas llogarisë përfundimtare, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor, të paguajë shumën prej 20 €, brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, ka ngritur aktakuzën e lartcekur ndaj të pandehurit M.Z...nga fshati K..., komuna e V..., për shkak të veprës penale Ndotja, degradimi apo shkatërrimi i mjedisit nga neni 338 paragrafi 1 të KPRK-s. Gjithashtu Prokuroria Themelore në Gjilan, ka paraqitur kërkesë për dhënjën e urdhërit ndëshkimorë, sipas të cilit të pandehurit ka kërkuar që t'i shqiptohet dënim me gjobë, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor ngase janë plotësuar kushtet ligjore për një gjë të tillë.

Gjyqtari, pasi shikoi dhe analizoi aktakuzën, kërkesën për lëshimin e urdhrin ndëshkimor dhe gjitha shkresat e tjera të lëndës, konstatoi se duhet të pranohet kërkesa e Prokurorisë Themelore për dhënien e urdhërit ndëshkimorë ndaj të pandehurit M.Z...nga fshati K..., komuna e V... dhe të pandehurit i shqiptoi dënim me gjobë, ngase të dhënat e paraqitura në aktakuzë dhe provat e bashkangjitura, ofrojnë bazë të mjaftueshme për dhënien e urdhrin ndëshkimor.

Gjendja faktike vërtetohet: procesverbali me numër 2145117, i datës 26.05.2023, sektori i rikthimit të humbjeve, raporti fillestar i incidentit me numër 2022-CG-0168, i dt.20.05.2022, deklarata e te pandehurit M.Z..., raporti i inspensionit të Komunës së Vitisë me nr.08-052/01-548 të datës 17.05.2022, procesverbali me nr.28/2022 të datës 16.05.2022 si dhe shkesa të tjera të lëndës, vërtetojnë se i pandehuri i lartcekur ka kryer veprën penale ndotja, degradimi apo shkatërrimi i mjedisit nga neni 338 paragrafi 1 të KPRK-s në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjykata e ka pranuar kërkesën e Prokurorisë Themelore dhe ndaj të pandehurit, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor ka shqiptuar dënim me gjobë, ngase sipas bindjes së kësaj gjykate, dënimi me gjobë është i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë së tij, si dhe me caktimin e dënimit me gjobë do të mund të arrihet qëllimi i dënimit, nga neni 38 të KPRK. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 452 paragrafi 1 të KPP, kurse vendimi mbi kërkesën pasurore juridike, është marrë duke u bazuar në nenit 462 paragrafi 2 të KPP. Nga të cekurat e më lartë dhe në bazë të nenit 495 të KPP, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-DEGA NË VITI
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.215/2022, Më 09.08.2024

Bashkëpunëtore profesionale,
Kadishe Ajvazi Demi

Gjyqtari,
Behar Ymeri d.v

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi i pandehuri ose mbrojtësi i tij, mund të paraqesin kundërshtim në afat prej 8 (tetë) ditëve nga dita e pranimit të njëjtit.